



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 32
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302
Prishtinë, më 26 dhjetor 2018, në orën 13:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Munguan: Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Drita Millaku, Haxhi Avdyli, Miljana Nikoliq dhe Naser Rugova.

Pjesëmarrës tjerë: Qëndresa Mejzini– KDI, Festina Veselaj - HANDIKOS dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektbuxhetit për vitin 2019, për sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Shqyrtimi i Projektbuxhetit për vitin 2019, për sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;

Kryetarja, tha se ne si Komision kemi caktuar këtë rend të ditës, me qëllim që ta shqyrtojmë buxhetin e vitit 2019, për sektorin e shëndetësisë dhe sektorin e punës dhe mirëqenies sociale dhe më pas ia dha fjalën Enver Hoti, nënkryetar, i cili njëherësh është edhe anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Enver Hoti, tha se sot në Komisionin për Buxhet dhe Financa kemi shqyrtuar kërkesat e organizatave buxhetore të nivelit qendror. E kam ngritur kërkesën e Klinikës së Onkologjisë, ndërsa përgjigjja e ministrit Hamza ishte se të gjitha lëvizjet dhe strukturimet e brendshme buxhetore duhet të bëhen brenda ministrisë. Mjetet duhet të merren nga buxheti të dedikuara për SHSKUK.

Flora Brovina, theksoi se unë kam diskutuar dhe jam dakorduar me ministrin e shëndetësisë për Ligjin për shërbimin mjekësor emergjent, i cili është dashtë të fillojë të zbatohet në janar të vitit 2018, por që kjo nuk u realizuar dhe ky ligj nuk nisi zbatimin dhe prapë nuk është ndarë buxhet për zbatimin e tij. Ky ligj është shumë i rëndësishëm, sidomos tani që po kemi shumë aksidente komunikacioni. Në këtë ligj janë përfshirë edhe disa ministri tjera, prandaj është e udhës të fillojë koordinimi në mes të këtyre ministrive dhe të fillojë zbatimi i ligjit në disa faza. Të paktën, të fillojë krijimi i qendrave të thirrjeve dhe nxjerrja e akteve nënligjore.

Besa Baftiu, kryetare, tha se kur e kemi pas në takim ministrin e shëndetësisë, i kemi shqyrtuar projeksionet buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë. E kemi parë se nuk janë marrë parasysh të gjitha kërkesat e klinikave sepse nuk ka buxhet të mjaftueshëm. Ne si komision, gjatë vizitës në Klinikën e Onkologjisë, ju kemi premtuar që do t'i përkrahim kërkesat buxhetore të kësaj klinike, pasi janë të arsyeshme edhe pse kostoja buxhetore e këtyre dy kërkesave është mjaft e lartë. Unë propozoj që ti bëjmë dy amendamente; një për aparaturat e nevojshme për këtë klinikë dhe një për zgjerim të objektit të Onkologjisë.

Fikrim Damka, tha se Komisioni i buxhetit i ka diskutuar këto kërkesa dhe është propozuar të zgjidhen brenda buxhetit të paraparë për aparatura brenda SHSKUK-së.

Enver Hoti, theksoi se këto kërkesa është dashur të zgjidhen brenda kodeve buxhetore të Ministrisë së Shëndetësisë.

Pas diskutimeve, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me shumicë votash propozoi në Ligjin për Buxhetin e vitit 2019, amendamentet si në vijim:

Amendamenti 1

Projekti (projekt i ri): Zgjerimi i hapësirës të Klinikës së Onkologjisë.

Ne kërkojmë që për Shërbimin Spitalor Klinik Universitare të Kosovës – SHSKUK, në kodin organizativ 22000, në Kodin e programit 70100- QKUK-Shërbimi Terciar Shëndetësor, për vitin 2019, për projekte kapitale të ndahet buxhet shtesë, në vlerë prej 500,000 €, për zgjerimin e hapësirë të Klinikës së Onkologjisë. Ndërsa, për vitin 2020, të ndahet buxhet për

këtë projekt, në shumen prej 750,000 €, po ashtu, buxhet i njëjte të ndahet edhe për vitin 2021, në shumen prej 750,000 €.

Amendamenti 2

Projekti: Blerja e aparaturave mjekësorë për klinikën e Onkologjisë.

Ne kërkojmë që për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës – SHSKUK, në kodin organizativ 22000, në Kodin e programit 70100 - QKUK-Shërbimi Terciar Shëndetësorë, për vitin 2019, për projektin (pajisje mjekësore) Aparat për radioterapi LINAC+ 2 Bunker + aksesori, të ndahet buxhet për blerjen e aparaturës për Klinikën e Onkologjisë. (Ndërtimi i dy bunkerëve për vendosjen e aparateve të rrezatimit. Vlera 500,000 €. Blerja e një aparat për radioterapi LINAC, për rrezatim. Vlera 3,000,000 €. Aksesori -dozimetri, fiksatorë, etj. Vlera 400,000 €).

3. Të ndryshme.

Besa Baftiu, kryetare, tha se për këtë pikë, po ua paraqes kërkesën e disa specialistëve të mjekisë, të cilët po kërkojnë të përfshihen në Ligjin e buxhetit, si punëtorë të rregullt. Këta specialistë e kanë fituar specializimin në mënyrë vullnetare dhe nuk marrin pagë nga Ministria e Shëndetësisë. Vitin e kaluar këta specialistë, janë paguar nga subvencionet, por ata tani po kërkojnë të përfshihen në paga të rregullta.

Bekim Haxhiu, theksoi se këta specialistë, kur i kanë marrë specializimet në mënyrë vullnetare, i kanë zgjedh ato specializime që i kanë dashtë, tani mund të punësohen vetëm kur të ketë ndonjë konkurs. Kjo është çështje menaxheriale e brendshme e Ministrisë së Shëndetësisë.

Enver Hoti, tha se, sa i përket Ligjit për shërbimin mjekësor emergjent, ky ligj ka kolizion me ligjet tjera. Ne e kemi Departamentin për Menaxhim të Emergjencave Civile.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU